




Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality



HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA-KOHOVVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Date
13.01.2020

Nr./No. organizatave	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	453-38		

RREGULLOREN
PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË
SUBVENCIONEVE

Dragash, 24.12.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality



Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040 (GZ, Nr. 28, 04.06.2008), Nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048 (GZ, Nr. 28, 03.06.2008) me plotësime dhe ndryshime, në zbatim të Nenit 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare – Shpenzimi i parave publike Nr.01/2013-MF (GZ, 28.05.2013) dhe Neni 32, pika 2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me dt.24.12.2019, miratoi:

RREGULLOREN
PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË
SUBVENCIONEVE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë rregullore, përcaktohet fushëveprimtaria për ndarjen e subvencioneve nga Komuna.

Neni 3

Përkufizimet

1. **Subvencionet** - përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në llogarinë rrjedhëse, ndërsa transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për qeveritë tjera, institucionet joprofitabile, familjet dhe individët.
2. **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën.

3. **Përfituesit** - nënkupton personat fizik dhe juridik që jetojnë dhe që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës.
4. **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Limitet buxhetore

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e miratuar të buxhetit për vitin fiskal.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës apo aplikacionit të protokoluara në Komunë të personit fizik apo juridik.
2. Komuna nuk mund të bëjë ndarje të subvencioneve në mungesë të kërkesës apo aplikacionit të protokoluara.
3. Personi fizik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet tatimore ndaj Komunës, në përjashtim të paragrafit 2 të nenit 20.
4. Personi juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara të gjitha obligimet ndaj Komunës.

Neni 6

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo të aplikimit të veçantë të personave fizik dhe juridik.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në Neni 9 dhe Neni 10 i kësaj Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet 20 ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.
5. Procedurat e financimit të OJQ-ve realizohen sipas Rregullores së Ministrisë së Financave me nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Ojq-ve.

Neni 7

Përfashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfashtim nga paragrafi 2 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore (mirëqenie sociale).
4. Të gjithë përfituesit të cilët nuk e zbatojnë Marrëveshjen sipas Nenit 11 të kësaj rregulloreje, nuk kanë të drejtë të aplikimit për përfitim të subvencioneve dhe u ndalohet për 3 (tre)vitet e ardhshme të jenë përfitues nga të gjitha kategoritë e subvencioneve të ndara nga Komuna, gjithashtu nese përfituesi nuk e zbaton Marrëveshjen, Komuna do te kërkoje kthimin e mjeteve përmes gjykatave dhe përmbauesve

Neni 8

Vendimmarrja

1. Kryetari i Komunës merr vendim lidhur me kërkesën e personit fizik apo juridik deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij Neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona fizik deri në shumën prej 1,000 €.
3. Për ndarje të subvencioneve mbi 1000 euro deri 2000 euro kuvendi delegon përgjegjesinë tek komiteti për politikë dhe financa(kuvendit duhet ti dergohen raporte 6 mujore të ndarjës së subvencioneve) ndërsa mbi 2000 euro për raste te jashtzakonshme vendos kuvendi komunal
4. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij Neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik sipas vlerësimit të Komisionit.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jipen nga Kryetari i Komunës.

3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil apo shërbyes profesional të Komunës.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 3 anëtarëve. Një nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave.
5. Anëtarët e Komisionit nga radhët e veta zgjedhin Kryesuesin e Komisionit.
6. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e baraisë gjinore.
7. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe t'i dorëzohet Kryetarit të Komunës.
8. Komisioni i rekomandon Kryetarit listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve.
9. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve i rekomandon Kryetarit të Komunës marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.
10. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me propozim të Komisionit.
11. Komuna publikon përfituesit e subvencioneve dhe të gjithë ata që nuk janë përfitues kanë të drejtë ankese.
12. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.
13. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
14. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 20 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Anëtarë të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil apo shërbyes profesional.
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.
4. Anëtarët e Komisionit nga radhët e veta zgjedhin Kryesuesin e Komisionit.
5. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe t'i dorëzohet Kryetarit të Komunës.
6. Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor i njësisë përkatëse.
7. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
8. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
9. Afati kohor për dorëzimin e ankesave do të jetë 5 ditë pune pas shpalljes së listës preliminare të përfituesve të subvencioneve.
10. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
11. Komuna i njofton të gjithë aplikuesit në bazë individuale për listën përfundimtare të përfituesve të subvencionevedhe i njofton për të drejtën e parashtrimit të ankesës në organet gjyqësore.
12. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ankesave në ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për shqyrtimin e drejtë të ankesave dhe përmbushje të kriterëve për ndarje të subvencioneve.
13. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e ankesave në ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e ankesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit të ankesave dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e ankesave në ndarje të subvencioneve.

14. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në ndarje të subvencioneve, në afat prej 20 ditë pune.

Neni 11

Marrëveshja për subvencionim

1. Personi juridik përfitues i subvencionit lidh marrëveshje me Komunën.
2. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe obligimet e njëjës palë ndaj tjetrës.
3. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesët tjera relevante për marrëveshjen.

Neni 12

Ndarja e subvencioneme për bashkëfinancim me donatorë

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bashkëfinancim me donatorë në kuadër të fushëveprimtarisë së bujqësisë, zhvillimit ekonomik, kulturës, banimit dhe punësimit.
2. Kryetari i Komunës lidh marrëveshjen e subvencionimit për bashkëfinancim me donatorë nga fushat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Komuna mund të bëjë bartjen e mjeteve tek llogaria e donatorit me qëllim të subvencionimit të përfituesve sipas marrëveshjes së lidhur.
4. Donatori është i obliguar që të dorëzojë raporte financiare dhe narrative mbi shpenzimin e mjeteve të Komunës.

Neni 13

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. bursa për student;
 - 1.2. bursa për nxënës në shkollë të mesme të lartë;
 - 1.3. bursa për nxënës në shkollë të mesme të ulët ;
 - 1.4. bursa për nxënës në shkollë fillore
 - 1.5. kuadrot deficitar;
 - 1.6. nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.7. gara apo kuize (aktivitete jashtëmësimore);
 - 1.8. botimin e librave/revistave;
 - 1.9. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.
3. Komuna ndan subvencione në arsim në baze të kërkesave në përjashtim të nënve nga 1.1-1.4 duhet të bëhet me thirrje publike

Neni 14

Procedurat për ndarjen e bursave

1. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave.
2. Shpallja publike duhet të publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.
3. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kritere të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1. Nota mesatare
 - 3.2. Numri i studentëve/nxënësve në familje;
 - 3.3. Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
 - 3.4. Rezultatet në gara;
 - 3.5. Gjendja ekonomike.
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1. Dokumenti i identifikimit;
 - 4.2. Certifikata e notave, të vërtetuar nga fakulteti;
 - 4.3. Certifikata e vitit kalendarik të studimeve;
 - 4.4. Certifikatë e vendbanimit;
 - 4.5. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
 - 4.6. Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
 - 4.7. Dëshmi për rezultatet në gara.
5. Aplikuesit nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal kanë qenë përfitues të një burse të ndarë nga Universiteti Publik ku studiojnë gjithashtu aplikues dhe përfitues nuk mund të jenë studentet e kolegjeve private.

Neni 15

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1 Zejet tradicionale;
 - 1.2 Aksesore;
 - 1.3 Agrobizneset;
 - 1.4 Teknologji Informative;
 - 1.5 Ndërmarrjet publike;
 - 1.6 Biznese inovative;
 - 1.7 Ndërmarrje sociale;
 - 1.8 Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;
 - 1.9 Inkubatorët e biznesit;
 - 1.10 "Start-up" bizneset;
 - 1.11 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;
 - 1.12 Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.

Neni 16

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. Bizneset prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
 - 1.2. Gratë, të rinjtë, zonat rurale, personat me nevoja të veçanta dhe komunitetet;
 - 1.3. Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta prej së paku 30% të vlerës;
 - 1.4. Bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale.
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunën e Dragashit.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Procedurat për ndarjen e subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Komuna ndan subvencione për zhvillim ekonomik përmes shpalljes publike.
2. Shpallja publike duhet të përcaktojë saktësisht llojet e bizneseve që mund të jenë përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik.

3. Shpallja publike duhet të përcaktojë saktësisht kriteret për ndarjen e subvencioneve.
4. Shpallja publike duhet të publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.
5. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 5.1. Plani i biznesit;
 - 5.2. Dokumenti identifikues;
 - 5.3. Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 5.4. Certifikata e biznesit;
 - 5.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 5.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 5.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 5.8. Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit.

Neni 18

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
 - 1.2. Organizimin e panairëve, seminareve;
 - 1.3. Bashkëfinancimin e projekteve me donatorë tjerë në fushën e bujqësisë;
 - 1.4. Projekteve në sektorin e pylltarisë.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi:
 - 2.1. Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - 2.2. Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve joshumicë.
3. Komuna bënë ndarjen e subvencioneve për bujqësi përmes thirrjes publike në përjashtim të pikës 1.3

Neni 19

Dokumentacioni i kërkuar për ndarjen e subvencioneve për bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.2. Certifikata e biznesit;
 - 1.3. Projekti dhe plani financiar;
 - 1.4. Fletëposedim për patundshmëri;

- 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- 1.8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 20

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimit dhe për mirëqenie sociale përmes kërkesave sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.
2. Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale jepen për:
 - 2.1. Rastet e rënda shëndetësore;
 - 2.2. Rastet e sëmundjeve jo të rënda por pa burim të të ardhurave;
 - 2.3. Trajtimi jashtë vendit;
 - 2.4. Fushatat e vëtedijesimit për shëndetin publik;
 - 2.5. Gjendja e rëndë ekonomike;
 - 2.6. Ndërtimi i shtëpive;
 - 2.7. Meremetimi i shtëpive.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 3.1. Numri i anëtarëve të familjes;
 - 3.2. Çështja e banimit;
 - 3.3. Kostoja e trajtimit;
 - 3.4. Gjendja ekonomike familjare;
 - 3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Përfituesit nga kjo kategori e subvencioneve nuk mund të përfitojnë dy vite rradhazi, në përjashtim të rasteve të rënda dhe të jashtëzakonshme (sëmundje malinje dhe dializë).
5. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 5.1. Diagnoza e mjekut specialist;
 - 5.2. Dokumenti i identifikimit;
 - 5.3. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 5.4. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore.

Neni 21

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1. Klubet sportive
- 1.2. Sportistët e dalluar
- 1.3. Garat sportive
- 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblet)
- 1.5. Teatrot amatore
- 1.6. Festivalet
- 1.7. Botimi i librave
- 1.8. Ekspozitat me fotografi
- 1.9. Aktivitete me karaktere garuese
- 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
- 1.11. Promovim i librave
- 1.12. Promovim i talentëve të rinjë
- 1.13. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
- 1.14. KVRL
- 1.15. Qendra Rinore
- 1.16. Aktivitete fetare

2. Komuna bën ndarjen e subvencioneve përmes shpalljeve publike në ueb faqen e komunës, mediat lokale, shpalljeve në vendet e frekuentuara, etj. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve.

3. Komuna bën ndarjen e subvencioneve edhe pa shpallje publike për kërkesat individuale për aktivitete kreative dhe inovative.

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 4.1 Projekt propozimi
- 4.2 Aplikacioni
- 4.3 Dokumenti identifikues
- 4.4 Certifikate e vendbanimit (për persona fizik)
- 4.5 Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
- 4.6 Dëshmi për pagesën e taksave komunale
- 4.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik)
- 4.8 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
- 4.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Neni 22

Projektet nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barzisë gjinore që promovojnë:

1. Komuna ndan subvencione nga fusha e të drejtave të njeriut barzisë gjinore duke përfshirë
 - 1.1 Projektet duhet të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në gjitha fushat jetësore, (barazia gjinore dhe mundësitë e barabarta, drejtat e fëmijëve, drejtat e personave me aftësi të kufizuara, drejtat e minoriteteve etj.
 - 1.2. Shuma e mjeteve caktohet sipas vlerësimit të prioritetit të çështjeve të cilat trajtohen dhe sipas lartësisë së mbështetjes nga ana e donatorit (nëse ka donator).
 - 1.3. Përkrahja financiare për promovime mediale të projekteve të të drejtave të njeriut.
 - 1.4. Përkrahja financiare për shenimin e ditëve të caktuara nderkombetare që kanë për qëllim promovimin dhe avokimin për një jetë pa dhunë me të drejta të barabarta në shoqëri për çdo kategori njëzore
 - 1.5. Përkrahje për manifestime të ndryshme për promovime të drejtave të njeriut.
 - 1.6. Projektet në fushën e personave me aftësi të kufizuara (mbulimi i shpenzimeve të qirasë) në rast nevojë dhe për projekte tjera për fuqizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, organeve të saja (Handikos) etj.

2.Komuna bën ndarjen e subvencioneve përmes shpalljeve publike në ueb faqen e Komunës, mediat lokale, shpalljeve në vendet e frekuentuara, etj. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve

3.Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 3.1 Projekt propozimi
- 3.2 Aplikacioni
- 3.3 Dokumenti identifikues
- 3.4 Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
- 3.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale
- 3.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik)
- 3.7 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
- 3.8 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Neni 23

Ndarja e subvencioneve për mbrojtjen e mjedisit

1. Komuna ndan subvencione për mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë dhe mos u kufizuar vetëm
 - 1.1 Shenimi i datave ekologjike me aktivitete mjedisore senzibilizuese me qëllim vetëdijesimin e popullatës në ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave natyrore
 - 1.2 Kampanja ekologjike për trajtimin ekologjik të mbeturinave

1.3 Aktivitete për prezantimin e biodiversitetin dhe vlerave natyrore të zonës së Dragashit

2. Komuna bën ndarjen e subvencioneve përmes shpalljeve publike në ueb faqen e komunës, media lokale, shpalljeve në vendet e frekuentuara, etj. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedura për ndarjen e subvencioneve
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1 Projekt propozimi
 - 3.2 Aplikacioni
 - 3.3 Dokumenti identifikues
 - 3.4 Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
 - 3.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale
 - 3.6 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
 - 3.7 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Neni 24

Ndarja e subvencioneve për raste të fatkeqësive të ndryshme

1. Kryetari i Komunes ne rastet e fatkeqësive te ndryshme apo gjendjes se jashtezakonshme mund te mbeshtese financiarisht personat fizik dhe juridik te cilet kane pesuar humbje te konsiderueshme ne te mira materiale te vertetuar me procesverbal dhe foto nga organet perkatese komunale apo ndonje organ tjetër i ngjashem kompetent per konstatimin, vertetimin dhe publikimin e gjendjes faktike.
2. Ne raste te tilla, Kryetari i Komunes merr vendim per mbeshtetje financiare me kerkesen e personit fizik apo juridik. (Pa shpallje publike)
3. Ne rastet e fatkeqësive dhe gjendjes se jashtezakonshme per marrjen e Vendimit parashtruesi i kerkeses duhet te bashkengjes dokumentacionin si vijon:
 - 3.1. Kerkesen te nenshkruar dhe protokoluar
 - 3.2. Dokument zyrtar mbi gjendjen e vertetuar faktike
 - 3.3. Fotokopja e leternjoftimit
 - 3.4. Konfirmimi per xhirollogarine bankare

Neni 25

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Personat fizik dhe juridik përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim.

Raporti duhet t'i këtë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta etj.).

3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i këtë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe Komunës.
5. Raportet nga Paragrafi 1 i këtij Neni protokolohehen dhe një kopje e tyre dorëzohet në Arkivin e Komunës.

Neni 26

Monitorimi i përfituesvetë subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të inicojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga Komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në periudhën kohore prej 3 vitesh nga data e përfitimit të subvencionit.
3. Komuna mund të bëjë vizita periodike tek përfituesit e subvencioneve, me theks të veçantë tek përfituesit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim të monitorimit të shfrytëzimit të drejtë dhe sipas marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.

Neni 27

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve, duke përfshirë edhe shumatat që iu janë ndarë, 10 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.
2. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 28

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore të miratuara nga institucionet qendrore aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

2. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari i Komunës përmes drejtorisë përgjegjëse të financave dhe drejtorive tjera përkatëse.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për ndarjen e subvencioneve me nr të protokollit 01.Nr.06-246/2 e datës 28.02.2013

Neni 29

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL, si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01Nr.060/01-31587/1

Data:24.12.2019

Dragash

Kryesuesi i Kuvendit

